

VENDIM
Nr. 529, datë 6.8.2014

**PËR PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, ME EKSPTERTË TË POLICISË SË
SHTETIT, NË MISIONIN PAQERUAJTËS TË
KOMBEVE TË BASHKUARA NË SUDANIN E
JUGUT (UNMISS)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 10 438, datë 28.6.2011, “Për pjesëmarrjen e Policisë së Shtetit, në misionine policore paqeruajtëse dhe humanitare jashtë vendit”, të nenit 47, të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007, “Për Policinë e Shtetit”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin e dy ekspertëve të Policisë së Shtetit në misionin paqeruajtës të Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut (UNMISS).

2. Misioni dhe detyrat e ekspertëve të Policisë së Shtetit do të jenë këshillimi dhe trajnimi i punonjësve të Policisë Kombëtare në Sudanin e Jugut, në mënyrë që të zhvillohet një forcë policore kombëtare e pavarur dhe profesionale, në përputhje me normat dhe standardet ndërkombëtare të OKB-së.

3. Kohëzgjatja e këtij misioni është për një periudhë fillestare 1 (një) vit, me mundësi zgjatjeje të këtij afati.

4. Efektet financiare për periudhën njëvjeçare, gjatë kryerjes së shërbimit, për shpenzimet e transportit vajtje-ardhje për në vendin e dislokimit, akomodimin, sigurimin shëndetësor dhe shpenzimet e jetës përballohen nga OKB-ja, bazuar edhe në udhërrëfyesin e Kombeve të Bashkuara për oficerët e policisë të emëruar në operacionet paqeruajtëse dhe në rregulloret e tjera përkatëse të Kombeve të Bashkuara.

5. Policia e Shtetit merr përsipër sigurimin e uniformës, pajisjeve dhe materialeve sipas listës së rekomanduar nga OKB-ja.

6. Efektet financiare për shpenzimet e parashikuara në pikën 5, janë sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi dhe përballohen nga Policia e Shtetit.

7. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

000/lekë

Llogaritja e shpenzimeve
Për personelin e policisë me mision në OKB (UNMISS), Sudani i Jugut-Juba

Nr.	Zërat e shpenzimeve	UNMISS, Sudani i Jugut-Juba		
		Numri i forcave	Kosto për një p/policie për fazë në 000/lekë	Kostoja totale për të gjithë kontigjentin në 000/lekë
1.	Sigurimi i uniformës, pajisjeve dhe materialeve shëndetësore, sipas kërkesave të OKB-së.	2	295	590
	TOTALI I SHPENZIMEVE			590